



DEMOCRACYPLUS

# RAPORT I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 02/L-52 MBI EDUKIMIN PARASHKOLLOR

DHJETOR, 2020





# **RAPORT I MONITORIMIT**

TË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 02/L-52 MBI  
EDUKIMIN PARASHKOLLOR

DHJETOR, 2020

Falënderojmë **National Endowment for Democracy (NED)** për përkrahjen financiare në këtë iniciativë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetei elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Design and Layout: **Envinion**

Për më shumë informata vizitoni **[www.dplus.org](http://www.dplus.org)**

# Përmbajtja

HYRJE.....	6
METODOLOGJIA .....	8
TË GJETURAT KRYESORE .....	9
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME POLITIKASH.....	24
SHTOJCA A: AKTET NËN-LIGJORE.....	25

## Hyrje

Edukimi i hershëm është ndër periudhat më të rëndësishme për zhvillimin psikologjik dhe emocional të fëmijës. Kësaj faze duhet kushtuar një rëndësi e madhe nga prindërit, edukatorët në kopsht dhe nga faktorët e tjerë socializimit, kjo pasi në edukimin e fëmijëve përveç prindërve merr pjesë e gjithë shoqëria. Studimet e shumta tregojnë që investimi në këtë fazë tek fëmijët krijon bazën për zhvillimin e mëtejshëm dhe krijimin e një gjenerate të shëndoshë fizikisht dhe mentalisht. Zhvillimi i hershëm është kritik edhe për faktin që në këtë periudhë truri zhvillohet me shpejtësi të madhe dhe ka kapacitet të lartë për ndryshim.

Të drejtat e fëmijëve dhe mirëqenia e tyre është e rregulluar me Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe mirëqenien e tyre, dhe janë të pranuar nga shumë shtete demokratike. Domosdoshmëria për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës.<sup>1</sup> Të gjitha këto instrumente ndërkombëtare mirëqenien e fëmijëve e shohin të domosdoshme, dhe shtetet nënshkruese të këtyre konventave pajtohen se përkujdesja ndaj fëmijëve duhet të jetë primare për shoqërinë e një vendi.

Sigurimi i mirëfilltë i mirëqenies së fëmijëve arrihet përmes investimit në arsim më cilësor që nga niveli parashkollor deri në nivel të shkollës së mesme. Përveç kësaj është e domosdoshme edhe ofrimi i barazisë së oportuniteteve për të gjithë kategoritë e fëmijëve, në mënyrë që të gjithë të kenë qasje në edukimin parafillor, sepse edukimi i hershëm ka një rëndësi të pazëvendësueshme në zhvillimin e fëmijëve.

Megjithë rëndësinë që ka edukimi i hershëm, Kosova ka ngecje të mëdha në përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor, kjo për shkak të mungesës së theksuar të Institucioneve Parashkollore publike si dhe, mos-përfshirje të të gjithë fëmijëve në këtë proces, me theks të veçantë të fëmijëve që jetojnë në zona rurale, atyre me asistencë sociale, fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijët nga grupet e marginalizuara.

Pengesat për avancimin e edukimit parafillor hasen për shkak të moszbatimit të ligjit për edukimin parafillor, mungesës së vlerësimit të zbatimit të këtij ligji, sfidë mbetet mospunësimi i grave për shkak të p/rgjegj/sis/ s/ mvik/qyrjes s/ f/mij/ve, kufizimi material i familjeve me asistencë sociale për t'i dërguar fëmijët në institucione parashkollore, mungesa e infrastrukturës fizike të kopshteve për fëmijët me nevoja të veçanta etj. Një ndër elementet e rëndësishme për forcimin e edukimit parashkollor në Kosovë është ndikimi në rritjen e punësimit të grave në shoqëri. Shifrat në këtë aspekt janë alarmante, sepse vetëm 13.7% e grave janë të punësuar ndërsa 79.6% janë joaktive.<sup>2</sup> Kjo shifër e rendit Kosovën si ndër vendet me përfshirjen më të ulët të grave në tregun e punës. Ky është një indikator i rëndësishëm për vlerësimin e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit dhe se pjes/marrja e lart/ e fëmijëve në edukimin parashkollor konsiderohet si një nga faktorët që mund të ndryshoj situatën.

1 Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara 'KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS', (1989). Mund të gjendet në: OHCHR | Convention on the Rights of the Child

2 Instituti GAP 'Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë. Raport Statistikor', (2019). Mund të gjendet në: [https://www.institutiqap.org/documents/15894\\_Rapor-ti%20Pun%C3%ABsimi%20dhe%20p%C3%ABfaq%C3%ABsimi%20i%20grave%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB%202019%20-finalALB%20-%202012.pdf](https://www.institutiqap.org/documents/15894_Rapor-ti%20Pun%C3%ABsimi%20dhe%20p%C3%ABfaq%C3%ABsimi%20i%20grave%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB%202019%20-finalALB%20-%202012.pdf)

Në vitin 2006, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 02L-52 mbi Edukimin Parashkollor. Ky ligj rregullon bazën juridike sipas së cilës organizohet edukimi parashkollor në Kosovë. Përveç tij, edukimi parashkollor rregullohet edhe me anë të ligjeve tjera, siç janë:

- *Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës*
- *Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë*

Dokumente tjera përcjellëse përfshijnë udhëzime administrative, strategji kombëtare, plane strategjike dhe kurrikula të ndryshme që përcaktojnë veprimin dhe dinamikat brenda edukimit parashkollor.



**SIGURIMI I MIRËFILLTË I MIRËQENIES SË FËMIJËVE ARRIHET PËRMES INVESTIMIT NË ARSIM MË CILËSOR QË NGA NIVELI PARASHKOLLOR DERI NË NIVEL TË SHKOLLËS SË MESME. PËRVEÇ KËSAJ ËSHTË E DOMOSDOSHME EDHE OFRIMI I BARAZISË SË OPORTUNITETEVE PËR TË GJITHË KATEGORITË E FËMIJËVE, NË MËNYRË QË TË GJITHË TË KENË QASJE NË EDUKIMIN PARAFILLOR, SEPSE EDUKIMI I HERSHËM KA NJË RËNDËSI TË PAZËVENDËSUESHME NË ZHVILLIMIN E FËMIJËVE.**

## Metodologjia

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është vlerësimi i përgjithshëm i zbatimit të Ligjit për Edukimin Parashkollor dhe informimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës lidhur me nivelin e zbatimit të këtij ligji, nevojën për intervenim në pjesë të caktuara të tij si dhe identifikimi i sfidave në të cilat has zbatimi dhe, adresimi i tyre në organet kompetente. qëllimi ka qenë edhe analizimi i përmbajtjes së ligjit për të vlerësuar nëse është në përputhje me aktet e tjera nenligjore, nëse është bërë kompletimi i infrasktrukturës ligjore dhe obligimeve në nivelin lokal e qendror të dala nga ky ligj dhe aktet nënligjore.

Në funksion të arritjes së qëllimeve të lartpërmendura, është përdorur metoda cilësore me të cilën i kemi interpretuar të dhënat, në shërbim të kësaj analize janë përdorur burimet primare dhe sekondare. Sa i përket burimeve primare janë intervistuar katër (4) përfaqësues të organizatave që merren me kujdesin dhe edukimin e fëmijëve, si dhe është intervistuar një (1) pjesëtare nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kultures. Për të vlerësuar zbatimin e Ligjit për Edukimin Parafillor janë analizuar aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me edukimin parafillor, Konventat Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve, raporte të organizatave vendore dhe ndërkombëtare lidhur me edukimin parafillor në Kosovë etj.



**SIGURIMI I MIRËFILLTË I MIRËQENIES SË FËMIJËVE ARRIHET PËRMES INVESTIMIT NË ARSIM MË CILËSOR QË NGA NIVELI PARASHKOLLOR DERI NË NIVEL TË SHKOLLËS SË MESME. PËRVEÇ KËSAJ ËSHTË E DOMOSDOSHME EDHE OFRIMI I BARAZISË SË OPORTUNITETEVE PËR TË GJITHË KATEGORITË E FËMIJËVE, NË MËNYRË QË TË GJITHË TË KENË QASJE NË EDUKIMIN PARAFILLOR, SEPSE EDUKIMI I HERSHËM KA NJË RËNDËSI TË PAZËVENDËSUESHME NË ZHVILLIMIN E FËMIJËVE.**



## Të gjeturat kryesore

Ligji mbi Edukimin Parashkollor (Nr. 02/L-52) është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 6 mars 2006, si pjesë e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja nr. 2001/9 e datës 15. Maj 2001).<sup>3</sup> Për ta plotësuar ligjin, MASHT ka nxjerrur udhëzime administrative e ndër më esenciale për funksionimin e institucioneve parashkollore janë trembdhjetë sosh (shih Shtojcën A):

Këto dhe akte nënligjore që derivojnë nga ligji, rregullojnë në masë të madhe bazën ligjore në zbatimin sa më efikas të tij, por siç do të shtjellohet edhe në vijim, pjesë të caktuarara të ligjit nuk janë objekt i zbatimit, duke shkaktuar kësh-tu mangësi në rregullimin e edukimit parashkollor në vend. Parimet bazë të përcaktuara në Ligj (neni 4) për edukimin në institucionet parashkollore janë:

- Barazia
- Gjithëpërfshirja
- Demokracia
- Autonomia e personelit
- Profesionalizmi dhe përgjegjësia
- Mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marr parasysh ndryshimet në mes të fëmijeve
- E drejta për të qenë ndryshe
- Zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijëve.

### A Gjithëpërfshirja

Në këtë parim i cili konsiderohet bazik për zbatimin e ligjit, pasi e tregon përfshirjen e të gjitha kategorive janë gjetur mungesa në zbatim të ligjit. Kosova ka vetëm dyzet e katër (44) institucione parashkollore publike në mbarë vendin duke mos garantuar gjithëpërfshirje në këtë nivel të rëndësishëm të edukimit dhe formimit të fëmijëve. Në vitin 2018 “në Kosovë rreth 9,100 fëmijë të moshës 1-5 vjeç janë të regjistruar në ndonjë institucion parashkollor. Kjo është shumë pak, duke marrë parasysh se në Kosovë janë rreth 110,000 fëmijë të moshës 1-5 vjeç, pra më pak se 10% e tyre kanë mundësi të vijnë edukimin parashkollor”.<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 'Ligji Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor', (2006). Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2401>

<sup>4</sup> Prononcim i Dukagjin Popovcit për Kallxo.com (12.10.2018), 'Kosova me vetëm 42 çerdhe publike'. Mund të gjendet në: <https://kallxo.com/shkurt/kosova-me-ve-tem-42-çerdhe-publike/>

**Tabela 1:** Numri i kopshteve publike parashkollore në vitet 2019 dhe 2020 në të gjitha komunat e Kosovë dhe vijueshmëria

Komunat 2019/2020	Parashkollor/çerdhe	Vijueshmëria
Deçan	-	-
Dragash	-	4 <sup>5</sup>
Ferizaj	1	202
Fushë Kosovë	1	148
Gjakovë	5	371
Gjilan	4	281
Glogovc	2	99
Hani i Elezit	-	-
Istog	5	332
Junik	-	32
Kaçanik	1	57
Kamenicë	1	108
Klinë	1	110
Leposaviq	-	-
Lipjan	1	86
Malishevë	1	86
Mamushë	1	-
Mitrovicë	1	218
Novobërdë	-	-
Obiliq	1	70

5 Këtu vijueshmëria është e llogaritur në kuadër të shkollave të cilat kanë nivele parashkollore.

Komunat 2019/2020	Parashkollor/çerdhe	Vijueshmëria
Pejë	1	99
Podujevë	1	61
Prishtinë	8	1,205
Prizren	-	13
Rahovec	1	
Shtërpcë	-	
Shtime	1	
Skënderaj	1	
Suharekë	3	
Viti	1	
Vushtrri	1	
Zubin Potok	-	
Zveçan	-	
Klllokot	-	
Ranillug	-	
Partesh	-	
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	

**Burimi:** Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Sipas këtyre statistikave trembëdhjetë (13) komuna të Republikës së Kosovës nuk kanë kopshte publike, gjë e cila i pamundëson familjeve me asistencë sociale apo atyre të cilët nuk kanë të ardhura materiale t'i dërgojnë fëmijët në kopshte. Ndërsa vijueshmëria shihet se është në nivel të lartë në komunat ku ka institucione parashkollore publike, pasi interesimi është i lartë në këto komuna është e nevojshme ndërtimi i më shumë kopshteve publike, në mënyrë që të gjitha kategoritë të kenë mundësinë t'i vijnë.

Qasja e kufizuar në institucionet parashkollore kryesisht publike të cilat kanë një kosto më të ultë dhe një reputacion të mirë të kujdesit të fëmijëve ndikon edhe në mos përfshirjen e grave në tregun e punës. Hulumtimi i Rrjetit të Grave të Kosovës nxjerr në pah që 88% e grave të papunësuar pohojnë se po të kishin pasur qasje dhe mundësi të përballeshme

ekonomike, ato do t'i dërgonin fëmijët e tyre në qendra të përkujdesit për fëmijë.<sup>6</sup> Prandaj, nisur nga këto premisa, ligji në fjalë dhe udhëzimet administrative nuk kanë garantuar kushtet për gjithëpërfshirje në institucione, me kushte të volitshme për prindërit e interesuar që t'i dërgojnë fëmijët në to.

Gjithpërfshirja në dispozitat ligjore gjithashtu parasheh përfshirjen e të gjithë fëmijëve në institucionet parashkollore pa marrë parasysh dallimet etnike, gjuhën, fenë etj. Por, një përfshirje edhe e komuniteteve jo shumicë në institucionet parashkollore nuk është e zbatueshme në Kosovë, pasi nuk ka fare kopshte publike publike në komunat me shumicë serbe, gjithashtu edhe në komunat që kanë kopshte publike vijueshmëria është shumë e ulët nga të gjithë pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.

**Tabela 2:** Të dhënat lidhur me vijueshmërinë e institucioneve publike parashkollore sipas përkatësisë etnike

Komunat 2019/2020	Shqiptar	Serb	Romë	Turq	Boshnjakë	Goranë
Deçan	-	-	-	-	-	-
Dragash	-	-	-	4	-	-
Ferizaj	211	-	-	-	-	-
Fushë Kosovë	147	-	-	-	-	-
Gjakovë	364	-	-	-	-	7
Gjilan	341	-	-	-	-	-
Glllogovc	109	-	-	-	-	-
Hani I Elezit	-	-	-	-	-	-
Istog	232	-	-	-	-	-
Junik	31	-	-	-	-	-
Kaçanik	57	-	-	-	-	-
Kamenicë	77	23	-	-	8	-

<sup>6</sup> Rrjeti i Grave të Kosovës – RrGK, 'Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë' (2016), f.8. Mund të gjendet në <https://womensnetwork.org/wpcontent/uploads/2018/10/20161103153827479.pdf>

Komunat 2019/2020	Shqiptar	Serb	Romë	Turq	Boshnjakë	Goranë
Klinë	109	-	-	-	-	-
Leposaviq	-	-	-	-	-	-
Lipjan	86	-	-	-	-	-
Malishevë	86	-	-	-	-	-
Mamushë	-	-	-	-	-	-
Mitrovicë	318	-	-	-	-	-
Novobërdë	-	-	-	-	-	-
Obiliq	70	-	-	-	-	-
Pejë	99	-	-	-	-	-
Podujevë	61	-	-	-	-	-
Prishtinë	1.195	-	10	-	-	-
Prizren	13	-	-	-	1	-
Rahovec	54	-	-	-	-	-
Shtërpcë	-	-	-	-	-	-
Shtime	45	-	-	-	-	-
Skënderaj	75	-	-	-	-	-
Suharekë	101	-	-	-	-	-
Viti	100	-	-	-	-	-
Vushtrri	130	-	-	-	-	-
Zubin Potok	-	-	-	-	-	-
Zveçan	-	-	-	-	-	-
Klllokot	-	-	-	-	-	-
Ranillug	:	:	:	:	:	:
Partesh	:	:	:	:	:	:

**Burimi:** Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Sipas këtyre të dhënave fëmijët nga komunitetet jo shumicë nuk e vijnë pothuajse fare institucionet publike parashkollore, shkak për këtë mund të jenë shumë arsye si p.sh mungesa e kopshteve publike në komuna, mosgatishmëria për t'i dërguar fëmijët në kopshte për shkak të frikës së mospranimit social, ndjenjës së inferioritetit etj. Veprimet e nevojshme për të shmangur këtë dukuri është lansimi i fushatave vetëdijësuese për të gjitha komunitetet jo shumicë, kjo për arsye që të jenë të informuar për rëndësinë që ka vijimi i kopshteve nga ana e fëmijëve, poashtu nevojitet edhe trajnimi i edukatorëve rreth edukimit dhe trajtimit të fëmijëve nga përkatësi të ndryshme, në mënyrë që të mos bëhet dallim mes fëmijëve dhe këtyre të fundit të ju mësohet toleranca dhe bashkëjetesa me kultura të ndryshme.

## **B** Përkrahja e iniciativave jopublike

Neni 27, pika 1 e Ligjit mbi Edukimin Parafillor përcakton që "MASHT-i dhe institucionet përgjegjëse komunale të edukimit parashkollor do të synojnë të përkrahin financiarisht iniciativat jopublike që ofrojnë shërbime të edukimit parashkollor. Me synim që të rritet përqindja e fëmijëve që kanë qasje në këtë lloj edukimi dhe cilësia e përgjithshme e edukimit parashkollor në Kosovë, MASHT-i dhe institucionet përgjegjëse komunale të edukimit parashkollor gjatë marrjes në konsideratë, përkrahjes financiare të këtyre iniciativave, duhet të ketë parasysh këto kritere:

- a) Pozita gjeografike e komunitetit ku ofrohet ky shërbim, duke marrë parasysh sidomos zonat rurale dhe ato të lëna pas dore;
- b) Shërbimet për fëmijë me nevoja të veçanta;
- c) Personeli i institucioneve parashkollore duhet të jenë të punësuar në baza të rregullta ligjore;
- d) Qasja të jetë e hapur për të gjithë fëmijët".<sup>7</sup>

Mosdefinimi i qartë i kësaj objektive dhe përcaktimi vetëm si synim ka krijuar kushte që një gjë e tillë mos të jetë praktikë në shumicën e komunave të Kosovës. 'Synimi' duhet të jetë i matshëm dhe i definuar në formë të detyrimit, kjo me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes sa më të gjerë të fëmijëve në këtë nivel edukimi. "As ligji dhe as korniza tjetër ligjore në shumë segmente nuk ka sqaruar kompetencat mes nivelit qendror të qeverisë (MASHT) dhe nivelit komunal dhe në mes institucioneve të ndryshme në nivelin qendror. Një situatë e tillë ka shkaktuar një shkallë të ultë të përfshirjes së fëmijëve dhe mungesë të kualitetit në ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nivelin parashkollor privat, dhe qëndrueshmërinë e qendrave të komunitetit".<sup>8</sup>

Megjithatë, raste të suksesshme të përfshirjes së komunitetit në hapjen e institucioneve parashkollore është Komuna e Prishtinës në të cilën janë hapur tashmë disa sosh e që janë dëshmuar si të suksesshëm. Udhëzimi Administrativ Nr. 42/2007 përcakton një rol të rëndësishëm të komunitetit në funksionimin e Institucioneve Parashkollore, duke u dhënë kompetenca të zgjeruara edhe në menaxhim. Këshilli shtatë anëtarësh mbledh opinionet e komunitetit dhe synon t'i adresoj ato në koordinim me komunën. Shembujt e suksesit nga Prishtina duhet të jenë nxitës që kjo formë të definohet edhe më tej duke obliguar komunat për të krijuar mundësi për krijimin e këtyre institucioneve, qoftë përmes ndarjes së linjave të veçanta buxhetore në shërbim të këtij qëllimi.

7 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 'Ligji Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor', (2006). Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2401>

8 Intervistë me Diellza Kukaj, Drejtore e Divizionit për Edukim Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (Prishtinë, 21 tetor 2020).

**Neni 27, pika 1 e Ligjit mbi Edukimin Parafillor përcakton që “MASHT-i dhe institucionet përgjegjëse komunale të edukimit parashkollor do të synojnë të përkrahin financiarisht iniciativat jopublike që ofrojnë shërbime të edukimit parashkollor. Me synim që të rritet përqindja e fëmijëve që kanë qasje në këtë lloj edukimi dhe cilësia e përgjithshme e edukimit parashkollor në Kosovë, MASHT-i dhe institucionet përgjegjëse komunale të edukimit parashkollor gjatë marrjes në konsideratë, përkrahjes financiare të këtyre iniciativave, duhet të ketë parasysh këto kritere:**

- A** Pozita gjeografike e komunitetit ku ofrohet ky shërbim, duke marrë parasysh sidomos zonat rurale dhe ato të lëna pas dore;
  - B** Shërbimet për fëmijë me nevoja të veçanta;
  - C** Personeli i institucioneve parashkollore duhet të jenë të punësuar në baza të rregullta ligjore;
  - D** Qasja të jetë e hapur për të gjithë fëmijët”.
-

## C Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta

Neni 2 i Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, pika 2.4 e vlerëson vijimin e edukimit parashkollor si vullnetar, edhe pse studime të shumta e vlerësojnë si shumë të rëndësishme këtë nivel të edukimit. “Zhvillimi i shëndetshëm në vitet e para mundëson ndërtimin e blloqeve të trurit për arritje akademike, produktivitet ekonomik, qytetari përgjegjëse, jetë të shëndetshme dhe prindërim të suksesshëm për gjeneratën tjetër”.<sup>9</sup>

Elemente të rëndësishme të parimeve të edukimit në institucione parashkollore është **sigurimi i mundësive të barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke pasur parasysht avantazhet dhe disavantazhet në mes të fëmijeve dhe të drejtën për të qenë ndryshe.**

Në këtë aspekt, rëndësi të veçantë ka përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijët me asistencë sociale dhe atyre nga komuniteti jo-shumicë.

Në nenin 6, përcaktohet se edukimi parashkollor është e drejtë e të gjithë fëmijëve përfshirë këtu edhe ata me nevoja të veçanta, i cili do të realizohet në përputhje me këtë ligj dhe me akte nënligjore. Në pikën 6.2 përcaktohen kategoritë e fëmijëve me nevoja të veçanta të cilat janë subjekt i këtij neni.

**Udhëzimi Administrativ 19/2016**, në pikë 6 të nenit 4 definon më saktë këtë të drejtë duke përcaktuar edhe disa kushte shtesë të cilat janë objekt analize dhe monitorimi në këtë raport. Në pikën 6.1 definohet që “fëmijët me dëmtime të rënda mund të përfshihen në IP, nëse institucioni e ka të siguruar kuadrin adekuat profesional dhe kushtet tjera të nevojshme, varësisht nga lloji i dëmtimit. Pra, sipas këtij neni fëmijët me dëmtime të rënda mund të vijojnë kopshtin vetëm nëse ka kuadër profesional, por nëse mungon diçka e tillë këta fëmijë nuk mund të vijojnë kopshtin, dhe për këtë ligji nuk e parasheh sigurimin e kuadrit profesional nga ana e komunës ose e institucioneve shtetërore, dhe kjo mbetet ndër sfidat kryesore në vijimin e kopshtit parashkollor nga të gjitha kategoritë.

Në Kosovë ekzistojnë edhe institucione speciale të cilat merren me edukimin e fëmijëve të cilët kanë dëmtime fizike, emocionale, psikike etj. Sipas ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës “Ministria mund të themelojë dhe mirëmbajë qendra të burimeve, shkolla speciale si dhe njësi të tjera që ofrojnë arsim special për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda apo të shumëfishta apo me vështirësi në mësimnxënie, të cilët vlerësohet se nuk janë në gjendje të arsimohen në shkolla komunale apo në institucione publike për aftësim”. Në Kosovë ekzistojnë gjithsej shtatë (7) shkolla të arsimit special të cilat merren me edukimin dhe trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, dëmtime fizike, emocionale, psikike etj.

<sup>9</sup> Behrami M., Pacolli F. dhe Ramqaj F. ‘Pse Edukimi i Hershëm është Zgjidhja’. (Friedrich Ebert Stiftung, 2020). Mund të gjendet në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/16274-20201022.pdf>



## Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta

Neni 2 i Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, pika 2.4 e vlerëson vijimin e edukimit parashkollor si vullnetar, edhe pse studime të shumta e vlerësojnë si shumë të rëndësishme këtë nivel të edukimit.

“Zhvillimi i shëndetshëm në vitet e para mundëson ndërtimin e blloqeve të trurit për arritje akademike, produktivitet ekonomik, qytetari pergjegjëse, jetë të shëndetshme dhe prindërim të suksesshëm për gjeneratën tjetër”

---

Në Kosovë ekzistojnë edhe institucione speciale të cilat merren me edukimin e fëmijëve të cilët kanë dëmtime fizike, emocionale, psikike etj. Sipas ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

“Ministria mund të themelojë dhe mirëmbajë qendra të burimeve, shkolla speciale si dhe njësi të tjera që ofrojnë arsim special për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda apo të shumëfishta apo me vështirësi në mësimnxënie, të cilët vlerësohet se nuk janë në gjendje të arsimohen në shkolla komunale apo në institucione publike për aftësim”.

**Tabela 3:** Të dhënat rreth vijimit të institucioneve parashkollore speciale nga këta fëmijë

2019/2020	Dëmtim intelektual	Dëmtim në të dëgjuar	Dëmtim në të parë	Dëmtime fizike
3 – 4 vjeç	3	1	-	-
4 - 5 vjeç	-	-	-	-
5 – 6 vjeç	2	1	4	-

**Burimi:** Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Sipas këtyre të dhënave del se vijueshmëria e institucioneve parashkollore speciale për vitin 2019 dhe 2020 nga fëmijët me dëmtime dhe nevoja të veçanta është i ulët. Numri i fëmijëve me vështirësi në të folur, komunikim dhe gjuhë që vijojnë këto kopshte speciale është më i lartë, ndërsa fëmijët me dëmtime fizike, autizëm, çrregullime emocionale dhe sindromën dawn nuk janë fare të përfshirë në këto institucione parashkollore. Ky fakt është shqetësues, pasi kjo kategori e fëmijëve ka më së shumti nevojë për kujdes, përkujdesje dhe socializim me fëmijët e tjerë. Mirëpo, Kosova nuk i plotëson standardet më të rëndësishme, duke mos iu ofruar hapsirë dhe mundësi këtyre fëmijëve që të vijojnë kopshtin. E gjithë kjo ka pasoja për fëmijët me nevoja të veçanta dhe atyre me dëmtime, pasi rezulton në formimin e ndjenjës së inferioritetit që nga faza e hershme dhe, pengesa në zhvillimin emocional dhe psikologjik për shkak të mos socializimit me fëmijë të tjerë dhe mbylljes brenda shtëpisë.

Nga intervistat e realizuara është vërejtur që ka gjithashtu mungesë përfshirje të kësaj kategorie, shkak i rrethanave të ndryshme e që rezulton me mos-zbatim të ligjit dhe parimeve bazë të tij. Nga Handikos Kosovo vlerësojnë që “Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta rregullohet vetëm me një nen dhe kjo është e pamjaftueshme, andaj duhet të shtohen mundësi tjera për këta fëmijë, si dhe privilegje”. Sfidë mbetet refuzimi nga ana e kopshtit i fëmijëve me nevoja të veçanta për t’u bërë pjesë e institucioneve parashkollore, pra refuzohet të bëhet regjistrimi i këtyre fëmijëve, dhe për këtë ligji nuk parasheh konsekuenca për ato institucione të cilat nuk i pranojnë fëmijet me nevoja të veçanta, dhe kjo pa asnjë arsytim, pasi duhet pasur një arsye me shkrim përse nuk i pranojnë këta fëmijë. Sfidë mbetet edhe mungesa e infrastrukturës së kopshteve të cilat nuk janë të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta, konkretisht ka mungesë të ashensorëve dhe shkallëve përkatëse për këta fëmijë.<sup>10</sup>

<sup>10</sup> Intervistë me Kaltrina Misini, përfaqësuese e Handikos Kosovo. (Prishtinë, 21 tetor 2020).

Dëmtime të shumëfishta	Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës	Autizëm	Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	Vështirësi -Çrregullime në të nxënë	Sindrom
1	9	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-
38	9	-	-	-	-

Ndërsa përfaqësuesja e Kolegjiut të Drejtorëve të Institucioneve Parashkollore tregon sfidat me të cilat përballen këto institucione në raport me akomodimin e këtyre fëmijëve. Ajo vlerëson që “gjendja e fëmijëve me kërkesa të veçanta nuk është e kënaqshme, pasi nuk ka hamonizim të programit për edukimin e veçantë të tyre, sipas rasteve të përmendura edukatorët nuk kanë dëshirë të merren me fëmijë që kanë kërkesa të veçanta, po ashtu mungon përgaditja profesionale e edukatorëve për këto raste, pasi në kopshte punojnë edukatore të cilat nuk kanë përgaditje për trajtimin emocional dhe psikologjik të fëmijëve me kërkesa të veçanta. Rekomandimi në këtë rast është që “në programin parashkollor në kuadër të Universitetit të Prishtinës të shtohen edhe lëndë të cilat do t’i përgadisnin në mënyrë profesionale edukatorët e kopshteve, dhe të jenë të gatshëm të merren edhe me raste të fëmijëve me kërkesa të veçanta”.<sup>11</sup>



**PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA RREGULLOHET VETËM ME NJË NEN DHE KJO ËSHTË E PAMJAFTUESHME, ANDAJ DUHET TË SHTOHEM MUNDËSI TJERA PËR KËTA FËMIJË, SI DHE PRIVILEGJE**

<sup>11</sup> Intervistë me Mevlude Murtezi, Kryetare e Kolegjiut të Drejtorëve të Institucioneve Parashkollore. (Prishtinë, 21 tetor 2020).

## D Përfshirja e fëmijëve nga familjet me asistencë sociale

Përfshirja e fëmijëve nga familjet me asistencë sociale definohet në nenin 24 (përcaktimi i tarifave të paguara nga prindërit) duke e përcaktuar që prindërit që marrin ndihmë sociale do të lirohet nga pagesat. Udhëzimi Administrativ 19/2016 në nenin 4, pika 7 përcakton që në rastet e liruara nga pagesa, prindërit/kujdestarët ligjor, duhet ta dëshmojnë këtë me dokument zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kërkesën e lirim, ndërsa në pikën 10 të po të njëjtin nen, obligohet komuna që të subvencionojë fëmijët e liruuar nga pagesa.

Në përgjigjen e dhënë nga përfaqësuesja e UNICEF Kosovo vlerësohet që ky nen nuk zbatohet në të gjitha rastet<sup>12</sup>, ndërsa të njëjtën e konfirmon edhe Kryetarja e Kolegjiut të Drejtorëve të Institucioneve Parashkollore. Nga kjo mund të konstatohet që respektimi i kësaj dispozite të rëndësishme që siguron pjesëmarrjen e rasteve sociale (faktor përmbajtësor për zhvillimin e mëtejshëm të tyre) është në nivele të ulta dhe se është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të mbikqyrin zbatimin e këtij ligji.

Udhëzimet administrative rregullojnë sistemin e tarifave dhe të përfshirjes së fëmijëve me asistencë sociale por edhe atyre me nevoja të veçanta vetëm në institucionet publike. Për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve në edukim parashkollor është i rëndësishëm që ndryshimet ligjore të përcaktojnë edhe forma alternative të përfshirjes edhe në institucionet private (qoftë përmes subvencionimit nga niveli komunal apo formave tjera), sepse ato përbëjnë numrin më të madh të institucioneve parashkollore në vend. Me theks të veçantë, investimet do të mund të subvencionoheshin në krijimin e kushteve më të mira për fëmijët me nevoja të veçanta, duke pasur parasysh edhe mundësinë e sektorit privat për të investuar më shumë në këtë drejtim.

## E Punësimi në institucione parashkollore


Sfidë për zbatimin e ligjit për edukimin parashkollor mbetet niveli i përgaditjes së stafit të angazhuar në institucione parashkollore. Pjesa e VI e Ligjit përcakton kriteret për punësim në institucione parashkollore, duke definuar edhe kërkesat lidhur me kualifikim. Në pikën 28.4 definohet qartë drejtimit të cilat duhet t'i kenë edukatorët për t'u punësuar në institucione parashkollore. Një fakt i rëndësishëm për t'u përmendur është edhe interesimi i grave dhe burrave për të punuar në institucionet parashkollore, në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat rreth punësimit të burrave dhe grave në institucionet parashkollore, në komunat e Kosovës.





**NJË FAKT I RËNDËSISHËM PËR T'U PËRMENDUR ËSHTË EDHE INTERESIMI I GRAVE DHE BURRAVE PËR TË PUNUAR NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE, NË TABELËN E MËPOSHTME JANË PARAQITUR TË DHËNAT RRETH PUNËSIMIT TË BURRAVE DHE GRAVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE, NË KOMUNAT E KOSOVËS.**

<sup>12</sup> Intervistë me Dafina Krasniqi, Përfaqësuese e UNICEF Kosovo. (Prishtinë, 19 tetor 2020).

**Tabela 4:** Të dhënat rreth punësimit të burrave dhe grave në institucionet parashkollore, në komunat e Kosovës

2019/2020	Niveli Parashkollor	
	 Burra	 Gra
Deçan	-	-
Dragash	-	-
Ferizaj	-	25
Fushë Kosovë	-	21
Gjakovë	-	45
Gjilan	-	44
Glogovc	-	15
Hani i Elezit	-	-
Istog	-	20
Junik	-	-
Kaçanik	-	4
Kamenicë	-	7
Klinë	-	5
Leposaviq	-	-
Lipjan	-	12
Malishevë	-	8
Mamushë	-	3
Mitrovicë	-	29
Novobërdë	-	-

2019/2020		Niveli Parashkollor	
Komunat	 Burra	 Gra	
Obiliq	-	9	
Pejë	-	39	
Podujevë	-	8	
Prishtinë	1	204	
Prizren	-	-	
Rahovec	-	4	
Shtërpcë	-	-	
Shtime	-	6	
Skënderaj	-	11	
Suharekë	-	8	
Viti	-	8	
Vushtrri	-	17	
Zubin Potok	-	-	
Zveçan	-	-	
Klllokot	-	-	
Ranillug	-	-	
Partesh	-	-	

**Burimi:** Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Sipas këtyre statistikave, përqindja e interesimit të burrave për të punuar në institucione parashkollore është krejtësisht e ulët, ndërsa numri i grave të interesuara është i lartë. Kjo paraqet një situatë shqetësuese, pasi ende vazhdon mendimi se pozita e edukatorit/es është i përshtatshëm vetëm për gratë. Pjesëmarrja e burrave në institucionet parashkollore mbetet larg standardeve evropiane dhe vendeve të zhvilluara, mirëpo kjo praktikë nuk duhet të vazhdohet pasi fëmijët në nivelin parashkollor kanë nevojë për një edukatorë/e profesional/e pa marrë parasysh gjininë.

Gjithashtu, pengesë në nivelin parashkollor në Kosovë mbetet edhe niveli akademik i edukatorëve, pasi objekt studimi i shumicës së edukatorëve mbetet edukimi i fëmijëve dhe përgaditja për nivelin shkollor dhe, nuk i kushtohet një rëndësi e madhe zhvillimit psikologjik dhe emocional të fëmijëve. Një indikator i rëndësishëm lidhur me këtë argument është fakti se në fakultetin e edukimit pranë Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina', në studimet themelore, lëndët që lidhen me zhvillimin socio-emocional dhe zhvillim profesional të mësimit janë lëndë zgjedhore, jo obligative. Për të pasur një nivel më të lartë të përgatitjes së edukatorëve është e nevojshme që lëndët të cilat lidhen me aftësitë kognitive, trajtimin e problemeve emocionale dhe psikologjike, të bëhen obligative në kuadër të studimeve themelore.

Përveç edukimit, për avancimin e aftësive të edukatorëve janë të nevojshme edhe trajnimet e vazhdueshme, të cilat janë të aprovuara nga Ministria e Arsimit duke promovuar kështu zhvillimin gjithëpërfshirës bazuar në trendet botërore.<sup>13</sup> Procesi i njëjtë i trajnimit duhet të zbatohet edhe në kopshtet private pasi këto kopshte nuk akreditohen nga Ministria e Arsimit.

## F Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit është element tjetër me rëndësi për të garantuar cilësinë dhe standardet e kërkuara nga ky ligj. Pjesa e VIII e Ligjit definon nivelet e mbikëqyrjes së ligjit duke përcaktuar që zbatueshmërinë e tij e bën Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, atë inspektuese inspeksioni i Arsimit, atë profesionale pedagogjike e punës së edukatoreve dhe bashkëpunëtoreve profesional realizohet në suaza të MASHT ose nga persona tjerë profesional me autorizim të MASHT. Për të realizuar mbikëqyrje kualitative duhet të shtohen kapacitetet njerëzore sepse në MASHT vetëm "dy zyrtarë merren me edukimin parashkollor"<sup>14</sup> e që sigurisht është e pamjaftueshme për një kuadër aq të gjerë të angazhimit. Për të siguruar një mbikëqyrje më përmbajtësore është e nevojshme që ndryshimet eventuale në ligj të përcaktojnë një ndarje më të mirë të kompetencave mes nivelit lokal dhe qendror dhe të avancoj struktura për koordinim ndër-institucional.

<sup>13</sup> Intervistë me Dafna Krasniqi, Përfaqësuese e UNICEF Kosovo. (Prishtinë, 20 tetor 2020).

<sup>14</sup> Po aty.

## Përfundime dhe Rekomandime politikash

**Ligji Nr. 02L-52** mbi edukimin parashkollor i miratuar në qershor të vitit 2006, përcakton qartë bazën ligjore për funksionimin e edukimit parashkollor në Kosovë. I njëjti është i kompletuar me aktet tjera nënligjore që rregullojnë fusha të caktuara të rregulluara me ligj. Megjithatë, nga ajo që është vlerësuar në këtë analizë, plotësimi i tij është i nevojshëm për të përmbushur nevojat e kohës e po ashtu për t'i adresuar disa nga mangësitë e përcaktuara. Adresimi i drejtë i këtij ligji do të kishte efekt zingjiror në disa fusha tjera siç janë cilësia e përgjithshme e arsimit në vend, por edhe me rritjen e punësimit të grave e që aktualisht është në nivele të ulëta.

- Ndryshimet në ligj duhet të përmbajnë metoda konkrete për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në kopshtet parashkollore. Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve jo shumicë në kopshte është kryesore, për bashkëjetesën arsimore mes shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve tjerë etnik. Në këtë drejtim nevojitet investim i madh në resurset materiale dhe humane, sidomos në komunat me komunitete jo shumicë.
- Sipas këtij hulumtimi është vërejtur mungesë e institucioneve parashkollore publike në trembëdhjetë komuna të Kosovës. Kjo zbrazëti duhet të plotësohet përmes ndërtimit të kopshteve publike në çdo komunë, po ashtu nevojitet edhe shtimi i numrit të kopshteve publike në komunat me numër më të madh të popullsisë. Përmes kësaj metode mund të sigurohet vijueshmëria e kopshteve nga të gjitha kategoritë.
- Licencimi i institucioneve private të edukimit parashkollor duhet të bëhet poashtu nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, në mënyrë që zbatim i ligji për këto kopshte të jetë i detyrueshëm. Kriter për licensim duhet të jetë formimi i kushteve infrastrukturore për fëmijëve me nevoja të veçanta, kjo duhet të vlejë edhe për kopshtet publike.
- Përfshirja e fëmijëve nga familjet me asistencë sociale duhet të adresohet më qartë nga Ligji mbi Edukim Parashkollor. Edhe pse Urdhëresa Administrative e sanksionon qartë këtë element për institucionet publike, një gjë e tillë nuk është e obligueshme për ato private. Prandaj, hartimi i ligjit duhet të përfshijë forma të përfshirjes së fëmijëve me asistencë sociale në institucione private të edukimit parashkollor, si një mënyrë për të integruar këtë kategori në shoqëri. Kjo mund të arrihet nëse komuna përkatëse i mbulon shpenzimet e fëmijëve që nuk i kanë kushtet për vijimin e kopshteve.
- Investimi në edukim jo-formal të stafit duhet të rregullohet përmes ligjit. Edukimi jo-formal duhet të jetë obligativ dhe i financuar nga komunat, pa përjashtim për të mbuluar mangësitë eventuale të stafit të angazhuar në këtë kategori. Ligji i ri duhet të parashikoj saktë nevojën për edukim jo formal të edukatorëve që të punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta apo edhe përfshirjen e asistentëve të cilat do të merreshin veçanërisht në këtë kategori. Nëse familja apo kopshti nuk mund të financojnë edukatorë për edukim jo formal, një gjë e tillë duhet të mbulohet nga komuna përkatëse, në mënyrë që të bëhet avantazhimi i të disavantazhuarëve.
- Rritja e stafit mbikëqyrës (Inspektorëve) në punën e institucioneve parashkollore duhet të jetë prioritet i institucioneve. Mungesa e stafit të angazhuar në monitorim të institucioneve parashkollore ka shkaktuar në shumë raste mos-zbatim efikas të tij. Inspektorët që i mbikëqyrin institucionet parashkollore duhet të jenë të pergaditur në këtë drejtim, pra të jenë të drejtimit parashkollor, poashtu inspektoriat duhet të inspektojnë kopshtet publike dhe private pa përjashtim, çdo muaj. Objekt inspektimi duhet të jetë zbatim i ligjit për institucionet parashkollore, vlerësimi i zbatimit të planprogramve mësimore, niveli i arsimit të edukatorëve etj.



## Shtojca A: Aktet nën-ligjore

- 1 Udhëzimi Administrativ **Nr. 12/2006** për Zbatimin e Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsmimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë, me datë 25.04.2006
- 2 Udhëzimi Administrativ **Nr. 13/2006** mbi Zbatimin e Kurrikulës për edukim parashkollor (3-6 vjeç), me datë 25.04.2006
- 3 Udhëzimi Administrativ **Nr. 41/2007** për Zbritjen e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore, me datë 09.10.2007.
- 4 Udhëzimi Administrativ **Nr. 42/2007** mbi Kushtet dhe mundësitë e përkrahjes së edukimit nga komuniteti, me datë 09.10.2007
- 5 Udhëzimi Administrativ **Nr. 43/2007** mbi Përcaktimin e procedurës, rasteve dhe afateve të ndërprerjes së punës në Institucione Parashkollore, me datë 09.10.2007.
- 6 Udhëzimi Administrativ **Nr. 44/2007** mbi Kohëzgjatjen e programeve tjera shkollore, me datë 09.10.2007.
- 7 Udhëzimi Administrativ **Nr. 45/2007** mbi Publikiminin (shpalljen e organizimit të edukimit në Institucionet parashkollore, me datë 09.10.2007.
- 8 Udhëzimi Administrativ **Nr. 46/2007** mbi Mënyrën e zgjedhjes së programeve parashkollore nga prindërit e fëmijeve, me datë 09.10.2007.
- 9 Udhëzimi Administrativ **Nr. 47/2007** mbi Fondin javor të orëve për edukatore, me datë 09.10.2007.
- 10 Udhëzimi Administrativ **Nr. 1/2008** mbi Këshillin Drejtues, përbërja, kompetencat e tij dhe përbërja e komisionit, mënyra e zgjedhjes së udhëheqësve dhe personelit të institucioneve parashkollore, me datë 03.03.2008.
- 11 Udhëzimi Administrativ **Nr. 2/2008** mbi Mjetet e dedikuara për financimin e edukimit parashkollor publik dhe mënyra e shpenzimit të tyre, me datë 03.03.2008.
- 12 Udhëzimi Administrativ **Nr. 15/2016** mbi Licencimin dhe Regjistrimin e Institucioneve Edukativo-Arsimore Parashkollore Private, me datë 03.08.2016.
- 13 Udhëzimi Administrativ **Nr. 19/2016** për përfshirjen e fëmijeve në Institucione Parashkollore në Kosovë , me datë 26.08.2016.





Mbështetur nga:

